RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Pularise

# " EKO Farm Sh.p.k."

**Dubravë- Komuna e Suharekës**

Suhareke, 2025

**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

# Pularise

Investitori:

## " EKO Farm Sh.p.k."

**Dubravë, Komuna e Suharekës**

Pronari:

Mr. Ramadan Maloku

Hartuesi i Raportit:

Rifat Morina

Suharekë, 2025

**PËRMBAJTJA**


HYRJE

1. QËLLIMI I INVESTIMIT TË KOMPANISË " ECO FARM " SH.P.K
   - 1.1 Vlera investive
2. BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI I PËRGATITJES SË RAPORTIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT
   1. Pozita gjeografike dhe relievi
   2. Popullata dhe Vendbanimet
   3. Karakteristikat klimatike
   4. Karakteristikat pedologjike
   5. Trashëgimia natyrore (Peisazhi, natyra, biodiversiteti dhe efektet vizuale)
   6. Ajri
   7. Karakteristikat hidrologjike
   8. Kanalizimi, furnizimi me uje dhe grumbullimi i mbeturinave
4. Pularia dhe thertorja " ECO Farm"
   1. Aktiviteti i Pularisë dhe thertores
   2. Përshkrimi infrastruktures se Objekteve dhe Paijsjeve
   3. Përshkrimi tekniko-teknologjik i pularisë
   4. Format e trajtimit te metejm te mbetjeve te
5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS
   1. Ndikimet në ajër
   2. Ndikimet në ujë
   3. Ndikimet në tokë
   4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë
   5. Ndikimi në vendbanime dhe popullatë
   6. Ndikimi nga zhurma
   7. Ndikimi në raste të aksidenteve mjedisore
6. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS
   1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër
   2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë
   3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë
   4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë
   5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë
   6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve nga Zhurma

7. Menaxhimi i mbeturinave
**8.** Masat për zvogëlimin e rrezikut në raste të aksidenteve mjedisore
7. PROGRAMI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMI
8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK
1. Objektivat e rikultivimit
2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve
3. Rikultivimi teknik
4. Rikultivimi agroteknik
5. Rikultivimi biologjik
9. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET
10. REFERENCAT
11. SHTOJCA

## HYRJE

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për **pularinë** e prodhimit të vezëve me kapacitet 20,000 pula veze-lënëse, është hartuar sipas kërkesës së investitorit **EKO FARM Sh.p.k** me seli në Dubravë të Komunës së Suharekes.

Faza e përgatitjes së objekteve dhe infrastrukturës së pularisë ka qenë e ndertuar më herët se përgatitja e këtij raporti, objekti ëshë i kompletuar me rrethojë mbrojtëse, instalimi i sistemit të ventilimit dhe izolimit termik, si dhe vendosja e pajisjeve moderne për menaxhimin e ushqimit dhe vezëve.

Meqenëse veprimtaria ka të bëjë me prodhimin ushqimor dhe menaxhimin e mbetjeve organike, hartimi i raportit të VNM-së ka për qëllim identifikimin paraprak të ndikimeve, propozimin e alternativave të ndryshme dhe masat adekuate që do të ndikojnë në evitimin ose minimizimin e ndikimeve në mjedis gjatë fazës së operimit të pularisë dhe trajtimit të mbetjeve.

Për hartimin e raportit janë përdorur të dhëna nga projekti i pularisë, plani i ndërtimit, teknologjia e përdorur për mbarështimin e shpendëve dhe menaxhimin e plehut organik, si dhe informacione nga burime të ndryshme shkencore dhe standarde ndërkombëtare. Një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë të dhënat e mbledhura nga terreni, fotografitë dhe matjet me GPS për përcaktimin e koordinatave të lokacionit.

Në bazë të informatave nga terreni dhe trendeve të sektorit, prodhimi i vezëve në Kosovë ka kërkesa të larta dhe konkurrenca është rritur, por një pjesë e konsiderueshme e fermave ekzistuese operojnë me teknologji të vjetruar. Ky projekt për një pulari moderne, me kapacitet 20,000 pula veze-lënëse, përbën një investim të arsyeshëm ekonomik dhe me reflektim pozitiv për ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e cilësisë së produkteve ushqimore.

Ky do të jetë një projekt që do të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e kontrolluar të emisioneve të amoniakut, trajtimin e ujërave të ndotura dhe përdorimin e plehut organik për qëllime bujqësore. Zbatimi i rekomandimeve të dala nga raporti do të mundësojë shmangien e efekteve negative edhe në rast të avarive apo fatkeqësive të mundshme.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është bërë duke u bazuar në inspektimet në terren dhe studimet e realizuara gjatë procesit të vlerësimit. Ndikimet në mjedis nga pularia janë vlerësuar si për periudhën e funksionimit, ashtu edhe për fazën pas-funksionimit.

Metodologjia dhe informacioni i përdorur është përshkruar në kapitujt vijues për çdo aspekt të vlerësuar.

## 1. QËLLIMI I INVESTIMIT TË " EKO Farm" Sh.p.k"

Qëllimi i ndërmarrjes **EKO FARM Sh.p.k** është të bëhet një ndërmarrje lidere në Kosovë në fushën e prodhimit dhe përpunimit të produkteve të shpendëve, duke përfshirë prodhimin e vezëve, mbarështimin e pulave dhe therjen e tyre në kushte higjieno-sanitare të kontrolluara. Me këtë aktivitet, ndërmarrja synon të jetë motor i zhvillimit ekonomik, duke inkurajuar praktika të qëndrueshme dhe të përgjegjshme në sektorin agro-ushqimor, si dhe duke kontribuar në sigurimin e ushqimit cilësor për tregun vendas dhe atë rajonal.

Ndërmarrja do të zhvillojë veprimtarinë e mbarështimit të pulave veze-lënëse dhe mishit të pulës në një pulari moderne, e pajisur me teknologji bashkëkohore për ushqimin, ndriçimin, ventilimin dhe mbledhjen e vezëve. Gjithashtu, do të operojë një thertore të certifikuar, e cila do të përmbushë standardet e BE-së për sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve.

Pularia dhe thertorja do të funksionojnë sipas rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi, duke respektuar kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Me anë të pajisjeve moderne dhe proceseve të kontrolluara, ndërmarrja do të sigurojë cilësi të lartë të produkteve dhe minimizim të ndikimeve në mjedis.

Me një përkufizim, qëllimi i veprimtarisë së **EKO FARM Sh.p.k** është:

- Prodhimi dhe tregtimi i vezëve të freskëta dhe mishit të pulës me cilësi të lartë,
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe përfitime ekonomike për zonën,
- Zbatimi i praktikave të qëndrueshme në mbarështim dhe përpunim,
- Menaxhimi i sigurt i mbetjeve organike përmes kompostimit dhe riciklimit të tyre për bujqësi,

- Përpunimi dhe paketimi i produkteve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare,
- Trajtimi i ujërave të ndotura dhe zvogëlimi i erërave të pakëndshme përmes sistemeve të filtrimit,
- Kontributi në zhvillimin e sektorit agro-ushqimor në Kosovë, duke rritur konkurrueshmërinë dhe cilësinë e produkteve vendore.

Meqenëse Kosova gjendet në një fazë zhvillimi dhe modernizimi të sektorit bujqësor e ushqimor, **EKO FARM Sh.p.k** synon të jetë një aktor kryesor dhe aktiv në këtë proces, duke sjellë teknologji moderne, standarde të larta të prodhimit dhe kujdes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit.

Nga ky aktivitet, ndërmarrja **EKO FARM Sh.p.k** do të mundësojë përmirësimin e situatës ekonomike dhe mjedisore si më poshtë:

- Sigurimi i produkteve ushqimore cilësore dhe të sigurta për konsumatorin,
- Rritja e ofertës vendore dhe zvogëlimi i importit të produkteve të shpendëve,
- Zbatimi i metodave të kontrolluara të menaxhimit të mbetjeve organike,
- Kontributi në përmirësimin e shëndetit publik përmes standardeve të larta të higjienës ushqimore,
- Krijimi i një modeli biznesi të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin.

### *1.1 Vlera Investive*

**LISTA E OBJEKTEVE DHE PAISJEVE**

| Nr | Emertimi I Paisjeve | Njesia | Sasia | Qmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 1 | Kafaza per pula | cope | 12000 | 1.2 | 14,400.00 € |
| 2 | Kafaza per pula | cope | 8000 | 1.2 | 9,600.00 € |
| **Totali I paisjeve** | | | | | **24,000.00 €** |

| Nr | LISTA E OBJEKTEVE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 1 | Objekti per prodhimin e vezeve | cope | 1 | 60,000.00 € | 60,000.00 € |
| 2 | Objekti per prodhimin e vezeve | cope | 1 | 60,000.00 € | 60,000.00 € |
| 3 | Objekti per rritjen e Zogzave per vez | cope | 1 | 45,000.00 € | 45,000.00 € |
| **Total Objektev** | | | | | **165,000.00 €** |

**TOTALI** **189,000.00 €**

## 1. BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI I PËRGATITJES SË RAPORTIT

Duke marrë në konsideratë karakteristikat, madhësinë e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe vendndodhjen e saj, projekti investues për ndërtimin dhe funksionimin e **pularisë** me kapacitet 20,000 pula veze-lënëse, investim i **EKO FARM Sh.p.k** me seli në Dubravë të Komunës së Suharekës, është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe i përket Shtojcës së Parë të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar korniza ligjore e Republikës së Kosovës dhe dokumentet administrative të Komunës së Suharekës. Korniza ligjore mjedisore në Kosovë përbëhet nga një sërë ligjesh për mbrojtjen e mjedisit dhe ligje të tjera që lidhen me planifikimin hapësinor, shëndetin publik dhe bujqësinë. Gjithashtu, këtij kuadri ligjor i bashkëngjiten edhe një numër aktesh nënligjore të nxjerra nga Ministritë përkatëse dhe Komuna, për rregullimin e segmenteve të veçanta të mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

Qëllimet e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis janë të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

**Qëllimet e hartimit të këtij raporti janë:**

- Evidentimi dhe klasifikimi i pasojave negative dhe pozitive që mund të shkaktojë veprimtaria e pularisë në mjedis,
- Vlerësimi i faktorëve mjedisorë që preken dhe përcaktimi i masave preventive dhe zbutëse për minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative të mundshme,
- Analizimi i proceseve të punës gjatë aktivitetit të pularisë dhe vlerësimi i tyre për ndikimet e mundshme në cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit,
- Hartimi i një plani për mbrojtjen dhe mirëadministrimin e mjedisit brenda dhe përreth objektit, me synim ruajtjen e higjienës, përmirësimin e kushteve ekologjike dhe estetike të zonës,
- Hartimi i planit të monitorimit të mjedisit për veprimtarinë e pularisë duke përcaktuar indikatorë të matshëm (p.sh., nivelet e amoniakut, cilësia e ujit të shkarkuar, menaxhimi i plehut organik).

# 3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

## 3.1.Pozita gjeografike dhe relievi

Komuna e Suharekës shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës, me pozitë gjeografike të favorshme për zhvillim ekonomik dhe lidhje të shpejta me qendrat kryesore urbane. Qyteti i Suharekës ndodhet përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë–Prizren, duke mundësuar lidhje të drejtpërdrejtë me Prishtinën (rreth 60 km) dhe Prizrenin (rreth 20 km), si dhe me komunat fqinje Rahovec, Malishevë, Lipjan dhe Dragash.

Komuna e Suharekës ka një sipërfaqe prej rreth 361 km² dhe karakterizohet nga terrene të përshtatshme për bujqësi, me klimë të butë dhe tokë pjellore që e bën të favorshme për zhvillimin e veprimtarive agro-ushqimore.

Lokacioni i ndërmarrjes "EKO FARM Sh.p.k" ndodhet në fshatin Dubravë, një zonë me potencial të lartë bujqësor dhe me qasje të lehtë në rrjetin rrugor kryesor. Pozita e saj mundëson furnizim të shpejtë të tregjeve lokale dhe rajonale me produkte të freskëta. Zona përreth karakterizohet nga terren i sheshtë dhe lehtësisht i punueshëm, i cili ofron kushte të favorshme për ndërtimin dhe funksionimin e objekteve të pularisë dhe thertores.

Dubrava ndodhet në pellgun e lumit Toplluha, një degë e Drinit të Bardhë, dhe mjedisi përreth ka ndikime të buta kontinentale me reshje mesatare vjetore të përshtatshme për veprimtari bujqësore. Zona nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë nga fatkeqësitë natyrore si përmbytjet apo rrëshqitjet e dheut, gjë që e bën të sigurt për investime afatgjata.





*Harta e lokacionit të  EKO Farm Sh.p.k*



Harta e lokacionit të EKO Farm Sh.p.k

## 3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Qendra komunale e Suharekës, si njësi administrative territoriale, përbëhet nga 42 njësi kadastrale dhe mbi 50 vendbanime. Në mesin e këtyre vendbanimeve bën pjesë edhe fshati Dubravë, në të cilin ndodhet lokacioni i EKO FARM Sh.p.k.

Fshati Dubravë llogaritet ndër vendbanimet me potencial të lartë bujqësor për nga cilësia e tokës dhe pozita strategjike pranë rrugëve kryesore të komunikacionit. Edhe pse ka një sipërfaqe të moderuar dhe një numër të kufizuar banorësh krahasuar me disa fshatra të tjerë të komunës, Dubrava njihet për traditën në bujqësi, blegtori dhe prodhim të vezëve, gjë që e bën lokacionin ideal për zhvillimin e veprimtarisë së pularisë dhe thertores së EKO FARM.

## *3.3. Karakteristikat klimatike*

Klima e Përgjithshme - Suhareka ndodhet në rajonin e Dukagjinit dhe e përcakton një klimë të tipit Cfb sipas sistemit Köppen – klimë mesatare, me verë të ngrohtë dhe dimër relativisht të butë. Klima është e ndërthurur nga ndikime mesdhetare dhe kontinentale.

Temperatura mesatare vjetore është rreth 11°C. Vlera maksimale absolute arrin 38.2°C, ndërsa dimrat kanë temperatura mesatare netësore rreth –4°C. Verat janë të nxehta me temperatura që arrijnë deri në 31°C. Amplituda termike vjetore është rreth 52.3°C.

Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 700 mm. Verat janë më të thata, ndërsa pranvera dhe vjeshta më të lagështa. Lagështia mesatare relative është rreth 74.3%, më e ulët në gusht (63.2%). Qielli mesatarisht ka 5/10 vranësira; gushti është më i kthjellti. Suhareka ka mbi 2,000 orë dielli në vit, që korrespondon me rreth 5.7 orë në ditë. Korriku ka më shumë diell, ndërsa dimri më pak.Shpejtësia mesatare e erës varion nga 1.3 m/s deri 2.4 m/s, me rrahje ekstreme deri në 31 m/s, sidomos gjatë pranverës.

Përmbledhje

| Parametri | Vlera tipike |
|---|---|
| Klasifikimi klimatik | Cfb – Mesdhetare e ftohtë-temperaturë |
| Temp. mesatare vjetore | Rreth 11°C |
| Ekstrem temperaturë | –4°C (dimër), 31–38°C (verë) |
| Reshje vjetore | Rreth 700 mm |
| Lagështia relative | 74.3% mesatare |
| Qielli mesatar | 5/10 vranësira |

| | |
|---|---|
| Orë dielli vjetore | ~2,000 orë |

### *3.4. Karakteristikat Pedologjike dhe Gjeologjike të Dubravës (Suharekë)*

Dubrava është një fshat i komunës së Suharekës (Therandë), në rrethin e Prizrenit, Kosovë. Ndodhet në një lartësi prej rreth 495 metrash mbi nivelin e detit. Gjeologjia e Kosovës është e shumëllojshme, duke përfshirë periudha nga Neo-Proterozoiku deri në Holocen. Zona ku ndodhet Dubrava përfshin formacione Paleozoike, Triasike dhe Terciare. Në pellgun Ibër–Sitnicë përfshihen formacione ranore dhe kuarc-shkallë, silikate ultrabazik dhe bazik (serpentin, amfibol, gabro, diabaz), sedimente Terciare (konglomerate, tufa, andezite), si dhe sedimente liqenore-lumore përgjatë lumenjve. Dubrava ka gjasa të ketë formacione metamorfike dhe sedimentare të vjetra.

Zona e Dubravës, ka tokë pjellore të përbërë kryesisht nga sedimente përmbytëse, tokë argjilore dhe tokë të ndikuar nga erozioni i kodrave. Këto toka janë të përshtatshme për bujqësi, kryesisht për kultura të thata dhe bujqësi kodrinore.

Përmbledhje Krahasuese

| Aspekti | Përmbajtja |
|---|---|
| Vendndodhja | Fshat në komunën e Suharekës, rreth 495 m mbi nivelin e detit |
| Gjeologjia | Formacione Paleozoike, Triasike, Terciare dhe Kuaternare (Pellgu Ibër–Sitnicë) |
| Pedologjia | Toka aluviale kodrinore, të mira për bujqësi |

### ***3.5.Trashëgimia natyrore (Peisazhi, natyra, biodiversiteti dhe efektet vizuale)***
### ***Zona të Mbrojtura pranë Dubravës – Suharekë***

Ky dokument paraqet zonat e mbrojtura dhe monumentet natyrore pranë fshatit Dubravë në komunën e Suharekës, Kosovë. Informacioni bazohet në burime publike dhe lista zyrtare të zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë.

Parku Kombëtar 'Sharri'- Park kombëtar që përfshin rreth 4.7% të territorit të komunës së Suharekës. Një nga zonat më të pasura me biodiversitet në rajon, me sipërfaqe 53,469 ha.

Rezervati Strikt 'Maja e Arnenit'- Rezervat natyre me status IUCN Ia, me sipërfaqe 30 ha, në rrethin e Prizrenit dhe afër Suharekës.

Rezervati 'Rusenica'- Rezervat i veçantë brenda Parkut Kombëtar 'Sharri', i krijuar për ruajtjen e linxhit ballkanik (Lynx lynx balcanicus), me sipërfaqe rreth 300 ha.

Monumente Natyrorë Lokale- Përfshijnë drunj të veçantë dhe burime ujore në vendbanime të ndryshme të komunës, si Bllacë, Savrova, Grejkoc, Muhlan, Papaz, Vraniq, Luzhnica, Reçan dhe Biraqa.

Përmbledhje

| Zona e Mbrojtur / Monument Natyror | Lloji | Afërsi me Dubravën |
|---|---|---|
| Parku Kombëtar 'Sharri' | Park Kombëtar (IUCN II) | Brenda komunës së Suharekës |
| Rezervati Strikt 'Maja e Arnenit' | Strict Nature Reserve (IUCN Ia) | Rreth Suharekës (Prizren) |
| Rezervati 'Rusenica' | Rezervat i veçantë | Brenda Parkut 'Sharri' |
| Monumente Natyrorë Lokale | Monumente të mbrojtura | Të shpërndara në vendbanime të komunës |




*Zonat e mbrojtura të natyrës në afërsi të lokacionit*

### *3.6.Ajri*

Në afërsi të lokacionit dhe në përgjithësi në komunën e Suharekës nuk ka ndonjë stacion që bën monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit, prandaj mungojnë të dhëna zyrtare mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej një vlerësim i saktë dhe i plotë i gjendjes së ajrit në këtë zonë.

Megjithatë, duke marrë parasysh karakterin kryesisht rural të Dubravës dhe mungesën e aktiviteteve industriale të mëdha në afërsi, mund të konkludohet se cilësia e ajrit në këtë zonë është përgjithësisht e mirë.

Shkaktarët potencialë që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit përfshijnë:

- Komunikacionin rrugor, kryesisht atë që zhvillohet në rrugët lokale dhe lidhjet me qendrat e tjera të komunës dhe me Prizrenin.



*Pamje nga pularia*

### *4.3. Përshkrimi tekniko-teknologjik i Pularisë* ***me Pula vojse***

- Fabrika e planifikuar e pularisë ka kapacitet 20,000 pula -vojse, të destinuara për prodhimin e vezëve të freskëta konsumi për tregun vendas dhe, nëse është e mundur, për eksport. Objektivi është sigurimi i një prodhimi të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë duke përdorur teknologji moderne per prodhimin të vezeve, në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së mjedisit.

- 2. Përshkrimi i objektit

  Tipi i ndërtesës: Objekt njëkatësh me konstruksion metalik ose betonarme, i mbyllur me panele sanduiç për izolim termik dhe akustik.

  - Përmasat orientuese

  Gjatësia: 60–80 m

  • Gjerësia: 20–25 m

  • Lartësia: 3.0–3.5 m në anët dhe deri 5 m në kulm.

- Dysheme: Betoni i armuar i lëmuar, me shtresë mbrojtëse kundër lagështisë dhe kimikateve.
- Izolimi: Termik dhe kundër lagështirës për kushte optimale klimatike.
- Sistemi i mbarështimit

Metoda e zgjedhur: Sistemi baterik me shumë nivele (multi-tier battery cages), që lejon optimizimin e hapësirës dhe automatizimin e proceseve kryesore. Dendësia e mbajtjes: 450–500 $cm^2$ sipërfaqe për çdo pulë, sipas standardeve evropiane. Shpërndarja: 4 rreshta baterish në gjatësi dhe 3–4 nivele kafazesh.

4. Pajisjet teknologjike kryesore

- Ushqyerja: Linja automatike e ushqyerjes me transportues spirale ose zinxhir, dhe silo të jashtme 10–15 ton.

- Ujitja: Sistem niplash automatik me presion të kontrolluar dhe depozitë tampon për 1–2 ditë furnizim.

- Mbledhja e vezëve: Transportues me rrip dhe klasifikim automatik sipas cilësisë dhe peshës.

- Menaxhimi i plehut: Sistem me rripa transportues drejt një platforme të mbuluar dhe të shtruar me beton.

- Ventilimi dhe klima: Ventilatorë aksialë, cooling pads për verë, ngrohës për dimër.

- Ndriçimi: LED me programues për ciklin e dritës (14–16 orë/ditë).

5. Cikli i prodhimit

Furnizimi me pulëza (mosha 16–18 javë)

Akomodimi dhe përshtatja (~1 javë)

Faza e prodhimit (nga java 19–20 deri në fund të ciklit 12–14 muaj)

Mbledhja, pastrimi dhe klasifikimi i vezëve

Paketimi dhe shpërndarja

6. Higjiena dhe biosiguria

- Dezinfektim i plotë i objektit para futjes së çdo tufë të re. Zbatimi i procedurës all-in, all-out. Kontroll veterinar dhe vaksinim sipas programit. Kufizim i hyrjes së personave joautorizuar.

- . Menaxhimi i mbetjeve
- Plehu i shpendëve ruhet në platformë të mbuluar dhe të papërshkueshme nga uji. Ujërat e ndotura trajtohen ose drejtohen në gropa septike. Mbetjet e ambalazhit riciklohen ose dorëzohen tek kompani të licencuara.
- . Prodhimi vjetor i pritshëm
- Mesatarja e prodhimit: 280–300 vezë/pulë/vit
- Prodhimi total: 5.6–6 milionë vezë në vit për kapacitetin 20,000 pula.



*Pamje te pularisë brenda*

### *4.4. Format e trajtimit të mëtejshëm të mbetjeve të pularisë*

Nga aktiviteti i pularisë për prodhimin e vezëve gjenerohen kryesisht mbetje organike të përbëra nga:

- Plehu i shpendëve (bajgat),
- Materiale shtrati (tallash, kashtë, copa druri),
- Mbetje ushqimore të papërdorura,
- Mbetje të përziera me pupla dhe pluhur organik.

Mbledhja dhe ruajtja fillestare

- Plehu i freskët transportohet nga sistemi i rripave transportues të kafazeve drejt një platforme të mbuluar dhe të shtruar me beton, e cila është e papërshkueshme nga uji për të parandaluar infiltrimin e lëngjeve në tokë.
- Platforma është e pajisur me kanale kullimi që drejtojnë çdo ujë të mundshëm drejt një grope septike ose depozite të veçantë.

Trajtimi në impiantin e kompostimit

- Plehu organik, së bashku me materialet e shtratit, dërgohet në impiantin e kompostimit që ndodhet në afërsi të fermës.
- Procesi i kompostimit kryhet në kushte të kontrolluara të temperaturës dhe lagështisë, duke arritur stabilizimin biologjik të materialit dhe eliminimin e patogjenëve.
- Cikli i kompostimit zgjat 6–8 javë dhe rezulton në një pleh organik të pasur me lëndë ushqyese, i cili mund të shitet si produkt i gatshëm për bujqësinë ose të përdoret për tokat e fermës.

Përfitimet e përdorimit të impiantit të kompostimit

- Redukton volumin e mbetjeve organike me 40–50%.
- Neutralizon erërat e pakëndshme.

- Shkatërron farat e barërave të këqija dhe agjentët patogjenë.

  Krijon një produkt të vlefshëm që gjeneron të ardhura shtesë.

  Mbetjet e tjera

- Mbetjet e pakta inorganike (plastikë, metale, ambalazh) mblidhen veçmas dhe dërgohen në kompani të licencuara për riciklim.
- Ujërat e ndotura nga pastrimi i objekteve dhe mjeteve filtrohen dhe trajtohen para shkarkimit.



Pamje nga impianti per kompostim te glacave

## 5. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Duke u bazuar në aktivitetin e firmës EKO Farm Sh.p.k., e cila operon me një kapacitet prej rreth 20,000 pulash veze-vojse, mund të parashikohen ndikimet eventuale dhe të mundshme në mjedis. Aktiviteti kryesor përfshin rritjen e pulave në kushte të kontrolluara, menaxhimin e ushqimit dhe ujitjes, grumbullimin e vezëve, si dhe menaxhimin e mbetjeve organike (pleh dhe mbetje ushqimore). Për shkak të masave teknike të marra dhe impiantit të kompostimit në vend, ndikimet në mjedis janë të kufizuara dhe të kontrollueshme.

### *5.1. Ndikimet në ajër*

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në një pulari me kapacitet të tillë lidhen kryesisht me pluhurin organik, gazrat që çlirohen gjatë procesit të fermentimit të plehut dhe gazrat e emetuar nga automjetet që kryejnë transportin e mallrave dhe materialeve. Pluhuri organik krijohet nga lëvizja e pulave, shpërndarja e ushqimit dhe nga sipërfaqet e thata brenda objektit. Gjatë fermentimit të plehut krijohen gazra si amoniaku ($NH_3$), metani ($CH_4$) dhe oksidet e azotit ($N_2O$), të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit në hapësirat e brendshme dhe në rrethinën e afërt. Masat parandaluese përfshijnë instalimin e sistemeve të ventilimit me filtra të specializuar për të reduktuar pluhurin, kontrollin e lagështisë relative në ambient për të ulur avullimin e amoniakut, si dhe pastrimin periodik të plehut për të reduktuar kohën e fermentimit brenda objektit. Automjetet transportuese duhet të jenë në gjendje teknike të mirë dhe me emetime të kufizuara.

### *5.2. Ndikimet në ujë*

Rreziku për ndotjen e ujërave lidhet kryesisht me infiltrimin e lëngjeve të plehut të freskët dhe mbetjeve organike në ujërat nëntokësore, ose shkarkimin e ujërave të pastrimit të ambienteve të brendshme në ujërat sipërfaqësore. Pa masa të duhura, këto ujëra mund të përmbajnë ngarkesë të lartë organike, baktere patogjene dhe përbërës kimikë që ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit. Për të shmangur këtë, plehu ruhet në platforma të mbuluara dhe të papërshkueshme nga uji. Kanale të dedikuara drejtojnë ujërat e pastrimit në një gropë septike ku kryhet një trajtim paraprak përpara shkarkimit ose përdorimit të tyre në kompostim. Sistemi i menaxhimit të ujërave të shiut është i ndarë nga ai i ujërave të ndotura, duke eliminuar rrezikun e përzierjes.

### *5.3. Ndikimet në tokë*

Ndotja e tokës mund të ndodhë nëse plehu ose mbetjet organike depozitohen në mënyrë jo të kontrolluar, ose nëse ndodhin rrjedhje aksidentale nga zonat e ruajtjes. Plehu i freskët përmban përbërës organikë dhe elemente kimike si azoti dhe fosfori, të cilat në sasi të larta mund të shkaktojnë eutrofikim të tokës dhe degradim të saj.
Masat parandaluese përfshijnë përdorimin e platformave betoni të izoluara për ruajtje, largimin periodik të plehut për kompostim, si dhe kryerjen e inspektimeve të rregullta për të identifikuar rrjedhjet ose dëmtimet në strukturat e ruajtjes.

### *5.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë*

Objekti i pularisë përbën një ndërhyrje vizuale në një zonë me karakter rural, duke krijuar kontrast me mjedisin bujqësor përreth. Megjithatë, ndikimi vizual mund të zbutet me masa gjelbërimi dhe rrethim estetik. Ndikimi në biodiversitet është minimal pasi zona nuk përbën habitat të rëndësishëm për speciet e egra. Flora dhe fauna përreth janë tipike të zonave rurale dhe nuk pritet të pësojnë ndryshime të mëdha nga aktiviteti i fermës.

### *5.5. Ndikimi në vendbanim dhe popullatë*

Pularia është vendosur në një distancë të mjaftueshme nga zonat e banuara, gjë që minimizon ndikimet direkte në banorë. Aktiviteti i fermës mund të krijojë mundësi punësimi për komunitetin lokal. Potenciali për shqetësime nga era dhe transporti është i kufizuar dhe menaxhohet përmes kompostimit të plehut dhe planifikimit të orareve të transportit për të shmangur kohët me aktivitet të lartë në zonë.

### *5.6. Ndikimi nga zhurma*

Burimet e zhurmës përfshijnë pajisjet e ventilimit, transportin e ushqimit dhe largimin e plehut, si dhe automjetet transportuese. Nivelet e zhurmës pritet të jenë brenda kufijve ligjorë për zona rurale. Masat parandaluese përfshijnë përdorimin e pajisjeve silenciatorë në ventilatorë dhe kufizimin e orareve të ngarkim-shkarkimit në mënyrë që të minimizohet shqetësimi për banorët.

### *5.7. Ndikimi në rast të aksidenteve mjedisore*

Rreziqet e mundshme përfshijnë rrjedhje të ujërave të ndotura jashtë zonës së kontrolluar dhe zjarre në objekt. Plehu i freskët mund të gjenerojë gazra të ndezshëm si metani nëse ruhet në kushte të papërshtatshme. Masat parandaluese përfshijnë ndërtimin e impiantit të kompostimit dhe ruajtjes së plehut me standarde të larta, paisjen me mjete kundër zjarrit dhe trajnime periodike të stafit për procedurat emergjente.

## *6. Masat për Zvogëlimin e Ndikimeve në Mjedis*

### *6.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër*

Gjatë aktivitetit të pularisë, burimet kryesore të ndotjes së ajrit përfshijnë pluhurin organik nga hapësirat e kafazeve, erërat nga plehu i shpendëve, si dhe emetimet nga automjetet e transportit të ushqimit dhe produkteve. Për të zbutur ndikimet në ajër do të merren këto masa:

- Instalimi i sistemeve të ventilimit me filtra pluhuri në objektet e prodhimit.
- Menaxhimi i plehut në mënyrë të kontrolluar dhe transportimi i tij direkt në impiantin e kompostimit.
- Mbjellja e brezave të gjelbër (drunj dhe shkurre) përreth objektit për reduktimin e erërave dhe pluhurit.
- Larja periodike e sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme për të ulur nivelet e pluhurit.

### ***6.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë***

Ujërat e ndotura nga pastrimi i ambienteve dhe pajisjeve mund të përmbajnë mbetje organike dhe materie të ngurta. Për zvogëlimin e ndikimeve në ujë do të ndërtohet:

- Sistemi i kanalizimit të mbyllur që çon ujërat në gropë septike dhe më pas në bunar filtrues.
- Rrjet kullues për ujërat e shiut të ndarë nga ujërat e ndotura.
- Pastrimi i rregullt i kanaleve dhe rezervuarëve për të parandaluar bllokimet.
- Ndalohet derdhja e ujërave të ndotura direkt në tokë ose në ujëra sipërfaqësorë.

### ***6.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë***

Për të parandaluar kontaminimin e tokës nga plehu dhe mbetjet organike:

- Plehu ruhet në platforma të betonizuara dhe të mbuluara.
- Transportimi kryhet me mjete të mbyllura për të shmangur derdhjet.
- Mbetjet e ngurta inorganike (plastikë, metal) depozitohen në kontejnerë të mbyllur.
- Sipërfaqet manipuluese betonizohen dhe lidhen me sistemin e drenazhimit.

### *6.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë*

Zona e pularisë do të rrethohet me gjelbërim për të përmirësuar pamjen estetike dhe për të krijuar habitate të vogla për faunën vendase. Ruhet flora ekzistuese aty ku është e mundur.

### *6.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë*

Megjithëse pularia ndodhet në një zonë rurale, për të minimizuar ndikimet tek banorët:

